



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E PËRGJITHSHME
PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË
SHKODËR**

**RAPORT VJETOR
2016**

PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË

SHKODËR

Shkodër me 15.02.2016

Analiza e punes per vitin 2016

Prokuroria Prane Gjykates se Shkalles se Pare Shkoder analizon ne kete raport treguesit e punes 1-vjeçare per vitin 2016, gjendjen e kriminalitetit dhe tendencat e tij ne territorin ku ushtrohet veprimtaria ligjore e kesaj prokurorie, arritjet, mangesite dhe problemet e evidentuara gjate punes ne kete periudhe, si dhe percaktimin e prioriteve dhe drejtimeve kryesore ne persosjen e metejshme te veprimtarise per vitin 2016.

Gjate vitit 2016, Prokuroria e Rrethit Gjyqesore Shkoder e ka ushtruar veprimtarine e saj ne mbeshtetje dhe respektim te plote te dispozitave kushtetuese dhe ligjore, duke u mbeshtetur qe te jape imazhin e nje drejtesie te barabarte per te gjithë.

Ushtrimi i kesaj veprimtarie kushtetuese dhe ligjore, ashtu sic edhe do te analizohet ne vijim te ketij raporti, eshte bere bazuar ne nje angazhim maksimal te te gjithë stafit te kesaj prokurorie, duke ndjekur dhe respektuar me perpikmeri edhe cdo urdher dhe udhezim te Prokurorit te Pergjithshem te Republikes se Shqiperise.

Gjate vitit 2016, per perballimin e punes dhe ushtrimin e veprimtarise Prokuroria Prane Gjykates se Shkalles se Pare Shkoder ka patur ne perberje te organikes se saj 17 prokurore, perfshire drejtuesin dhe 2 zv/drejtuesa, 10 oficeret e policise gjyqesore. Po keshtu, per ushtrimin efikas te veprimtarise se kesaj prokurorie, nje ndihme dhe bashkepunim te rendesishem kane dhene edhe oficeret e policise gjyqesore te Drejtorise se Policise Qarkut Shkoder si dhe ato te Komisarariatit te Policise Shkoder, ato te Komisarariatit te Policise M.Madhe dhe Komisarariatit te Policise Vau-Dejes te cilet kane mbajtur peshen te konsiderueshme ne hetimin e ceshtjeve penale te rregjistruar gjate ketij viti.

Rezulton se gjate kesaj periudhe 1-vjecare, nga ana e prokuroreve te kesaj prokurorie eshte ushtruar ndjekja penale dhe jane ndjekur procese gjyqesore ne nje numer te konsiderueshem ceshtjesh penale, te rregjistruara per nje larmi te ndryshme veprash penale.

Falë angazhimit të prokurorëve në drejtimet më kryesore të ushtrimit të funksioneve dhe detyrave të tyre, në veprimtarinë e organit tone, vihet re qendrueshmëri e treguesve sasiorë dhe cilësorë të punës së organit të prokurorisë.


Me konkretisht, ne vijim te ketij raporti do te jepen te dhenat statistikore te punes dhe veprimtarise se Prokurorise se Rrethit Gjyqesor Shkoder, si dhe do te behet nje analize e detajuar e ketyre treguesve, duke evidentuar per cdo pjese te tyre, arritjet dhe problemet e evidentuara, si dhe percaktimin e drejtimeve kryesore per permisimin e metejshem te veprimtarise tone per vitin 2016.

Treguesit e ceshtjeve penale te trajtuara gjate vitit 2016.


Gjate vitit 2016 nga Prokuroria Prane Gjykates se Shkalles se Pare Shkoder eshte ushtruar ndjekja penale dhe jane trajtuar 4526 ceshtje penale, duke perfshire ne kete shifer ceshtjet penale te mbartura nga viti 2015, 1034 procedime, te reja 2196 ceshtje penale dhe 437 rifillime. Gjithashtu kete vit eshte vendosur mosfillimi per 859 materiale proceduriale.

Me konkretisht treguesit e ceshtjeve penale te trajtuara gjate vitit 2016, krahasuar edhe me treguesit e vitit 2015, jane si me poshte;


ÇESHTJET E HETUARA 2016 (4526)



ÇESHTJET E HETUARA 2015 (3418)



Mosfillime 2015 - 2016



Nga studimi i ketyre treguesve rezulton se ngarkesa totale e ceshtje penale te trajtuara nga ana e Prokurorise se Rrethit Gjyqesor Shkoder gjate vitit 2016 ka qenë pak me e larte se ajo e vitit 2015

Per te krijuar nje tablo me te plote e me te sakte te punes qe kemi perballuar gjate vitit 2016, le ti analizojme keto tregues duke pasqyruar jo vetem rezultatet statistikore por edhe problemet e shqetesimet qe kemi hasur, menyren si i kemi zgjidhur etj.

Nga analiza e treguesve statistikor rezulton se ne totalin e ceshtjeve 4526 gjate vitit 2016, duke perfshire edhe ceshtjet e mbartura te viteve me pare ne Prokurorine e Rrethit Gjyqesor Shkoder, i eshte dhene zgjidhje ligjore per procedimet penale si me poshte:


Eshte vendosur pushimi per	740	procedime
Eshte vendosur pezullimi per	785	procedime
Jane transferuar	39	procedime
Jane derguar gjykates	1202	procedime
Eshte vendosur mosfillimi per	859	kallzime

Mbeten ne hetim paraprak dhe **737** procedime (ne keta procedime duhet te perfshihen dhe **70 bashkime procedimesh**)

Keto tregues tregon se efikasiteti i punes se prokurorise ka qene maksimal dhe trajtimi i ceshtjeve penale eshte bere me pergjegjshmeri dhe brenda afateve optimale ligjore.

Burimet e referimit te ceshtjeve penale te rregjistruara gjate vitit 2016.

Me konkretisht treguesit e burimeve te referimit te ceshtjeve penale te rregjistruara gjate vitit 2016 jane si me poshte:



Persa i perket ceshtjeve penale te rregjistruara kryesisht nga organi i prokurorise, me nenet perkates si: Neni 259, neni 248, Neni 186, Neni 189 dhe Neni 244 te ndjekura Kryesisht nga Njesia e Perbashket Hetimore, qe pas ndryshimeve Kushtetuese dhe Ligjore nuk do kete me këtë emër.

Treguesit e menyres se perfundimit te ceshtjeve penale te trajtuara gjate vitit 2016.

Gjatë vitit 2016 në organin e prokurorisë janë trajtuar njoftime për vepra penale të ndodhura dhe janë ndjekur penalisht 3307 procedime penale, prej të cilave janë regjistruar në total 2187 procedime penale; janë mbartur nga viti i kaluar 1034 procedime penale dhe janë rifilluar 83 procedime, dhe është vendosur mosfillimi për 868 materiale procedurale

Gjatë vitit 2016, nga Prokuroria Shkoder, është ngritur dhe është përfaqësuar akuza në gjykatë për 1202 procedime me 874 të pandehur ku 260 prej tyre me arrest ne burg. Gjithashtu, janë paraqitur në gjykatë 8 kërkesa për caktimin e masave të sigurimit personal (arrest me burg ne mungese) për persona nën hetim.

Per sa me siper, gjate vitit 2016, menyre e perfundimit te procedimeve penale eshte;

1202 - ceshtje penale jane derguar ne gjykate

740 - ceshtje penale jane pushuar.

785 - ceshtje penale jane pezulluar.

39 - procedime penale jane transferuar.

1034 - procedime penale jane mbartur nga viti 2015

Ketu duhet te theksojme dhe faktin qe jane rifilluar dhe pushuar procedime penale per efekte te parashkrimit te afateve te ndjekjes penale si dhe amnistia .

Nga krahasimi i te dhenave te mesiperme rezulton se gjate vitit 2016 eshte rritur numri i ceshtjeve penale te pezulluara per mosidentifikim te autoreve te kryerjes se veprave penale, pjesa me e madhe e te cilave kane qene te rregjistruara per vepren penale te “Kultivimit te Bimeve Narkotike”, parashikuar nga neni 284 i Kodit Penal.

Ka pesuar renie pezullimi tek ceshtjet penale te “Vjedhjes”, parashikuar nga Neni 134, nga 296 ceshtje te vitit 2015, ne 211 per vitin 2016. Kjo tregon eshte rritur zbulueshmeria e autoreve te vepres penale eshte rritur.

Po kështu, nga krahasimi i treguesve të ceshtjeve të trajtuara gjatë vitit 2016 me ato të vitit 2015, duke mbajtur parasysh edhe raportin me ato të rregjistruara gjatë secilit vit, rezulton se ka rritje të treguesve të tjere, siç është vepra penale e kultivimit të lendeve narkotike ka rritje, vepra penale e drejtimit të mjetit në mënyrë parregullt, kalim i paligjshëm i kufirit, vepra penale e falsifikimit, ndertimet e paligjshme, vepra penale e vrasjeje që shihet qartë tek numri i ceshtjeve gjatë vitit 2016. Sa i përket veprave të tjera, duhet theksuar se këtë vit ka një rritje të veprave penale të armembajtjes pa leje .

Treguesit e veprave penale te rregjistruara dhe tendenca e kriminalitetit gjate vitit 2016.

Gjate vitit 2016 jane rregjistruar nje numer i kosiderueshem veprash penale nga te cilat do te analizojme disa nga veprat ne vecanti, te cilat lidhen edhe problematiken dhe tendencen e kriminalitetit gjate vitit 2015 dhe pjesen tjeter do t'a analizojme me grupime veprash, sipas marredhenieve juridike qe cenohen.

1.Per vepren penale te Kultivimit Bimeve Narkotike parashikuar nga neni 284 i Kodit Penal, e cila ze nje vend te konsiderueshem ne raport me veprat penale te tjera te rregjistruara gjate ketij viti, do te theksonim se ka nje tendence ne rritje ne krahasim me vitin e kaluar. Keshtu, nga numri i pergjithshem i ceshtjeve te rregjistruara gjate vitit 2016, vetem per vepren penale te Kultivimit Bimeve Narkotike, jane rregjistruar 295 ceshtje.

2.Per vepren penale te “Ndertimit pa leje” parashikuar nga neni 199/a te Kodit Penal, rezulton se gjate vitit 2016 jane trajtuar ne total 121 ceshtje penale. Ajo qe rezulton nga krahasimi i te dhenave lidhur me kete veper penale, eshte fakti se numri i ceshtjeve per kete veper eshte me nje tendencë rritje.

3.Per vepren penale te “Vrasjes”, parashikuar nga nenet 76, 78 dhe 79/è dhe 79/c te Kodit Penal, rezulton se gjate vitit 2016 jane trajtuar ne total 23 ceshtje te reja.

Per procedimet penale derguar gjyqit vlen te citohet fakti se ato jane si rezultat i veprimeve te shpejta dhe profesionale ku eshte arritur te zbulohet autori i kryerjes se vepres se rende penale dhe venia e tij perpara drejtesise

4.Per vepren penale te “Drejtimit mjeteve ne menyre te parregullt”, parashikuar nga neni 291 te Kodit Penal, rezulton se gjate vitit 2016 jane trajtuar ne total 308 ceshtje te reja.

5.Per vepren penale te “Kalim i paligjshem i Kufirit”, parashikuar nga neni 297 te Kodit Penal, rezulton se gjate vitit 2016 jane trajtuar ne total 50 ceshtje te reja.

6.Per vepren penale te “Falsifikim i Dokumenteve”, parashikuar nga neni 186 te Kodit Penal, rezulton se gjate vitit 2016 jane trajtuar ne total 55 ceshtje te reja.

Ne menyre te detajuar tendencen e kriminalitetit per 2015 dhe 2016 , paraqitur si me poshte:

Mosfillimet e procedimeve penale gjate vitit 2016.

Nga studimi i te dhenave statistikore, rezulton se gjate vitin 2016 eshte vendosur mosfillillimi per 868 materiale kallzuese apo te referuara, te cilat ne krahasim me numrin e ratseve te mosfilluara ne vitin 2015 është më i larte. Nga keto shume raste te mosfillimit te procedimeve penale, nje pjese e konsiderueshme jane mosfilluar per vepren penale te “Shkeljes se rregullave te qarkullimit rrugor”, “shkaktimit e vetevrasjes”, “te demtimeve te tjera me dashje”, “shkaterrim i prones “dhe “Fallsifikimit te dokumentave”, “shperdorim detyre”, “vetgjqyesi”, “prerje paligjshem pyjeve”, “pushtim toke”, “Ndertim I paligjshem”, “shkaterim I prones me zjarr”, etj., vepra keto te parashikuara nga nenet 290, 90,150, 151, 248, 277 , 205, 200, 199/a/1 dhe 186 te Kodit Penal. Ne total nga 868 materiale kallezimi te mosfilluara, ne 10 raste Gjykata e Rrethit Gjyqesor Shkoder ka vendosur prishjen e vendimit te mosfillimit dhe vazhdimin e hetimeve. Ne 16 raste nuk eshte miratuar nga Drejtuesi i Prokurorise vendimi i mosfillimit dhe eshte urdheruar fillimi i proçedimit penal. Ky tregues pasqyron ne menyre te qarte se vleresimi i materialeve te referuara ne Prokurorine e Rrethit Gjyqesor Shkoder, para se te urdherohej rregjistrimi i tyre si ceshtje penale ka qene profesional, i plote dhe ligjor.

Ne te gjitha rastet eshte bere vleresimi i duhur i materialeve te kallzuara, ne pjesen me te madhe te tyre jane kryer dhe veprime ne kuadrin e verifikimeve, dhe pas vendimarrjes per mosfillimin e çeshtjes ne te gjitha rastet eshte respektuar njoftimi i kallzuesit apo paleve qe kane te drejten e marrjes dijeni.

Nga totali I çeshtjeve te mosfilluara, ne gjykatë janë ankimuar 49 vendime mosfillimi. Gjykata ne perfundim te shqyrtimit ne 22 raste ka vendosur lenien ne fuqi te vendimeve te mosfillimit, 9 prej te cilave jane ankimuar dhe ndodhen per shqyrtim ne Gjykatën e Apelit. Ne 13 raste Gjykata ka vendosur prishjen e vendimeve te mofillimit, Prej tyre 11 raste jane ankimuar nga Prokurori dhe ndodhen per shqyrtim ne Gjykatën e Apelit. Ne 6 raste eshte pushuar Gjykimi, per 1 rast eshte vendosur mos kopetence dhe per 7 raste te tjera jane ne shqyrtim prane Gjykates se Shkalles se Pare Shkoder.

Çeshtjet penale te gjykuara gjate vitit 2016.

Rezulton se gjate ketij viti jane derguar per gjykim prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Shkoder 1202 ceshtje penale, jane me shume ne krahasim me ceshtjet penale te trajtuara se gjate vitit 2015 (1074 ceshtje). Pjesen me te madhe e zene ceshtjet penale te rregjistruara per veprat penale te Mashtrim me sigurimet neni 145, Vjedhje neni 134, Drejtim Mjeti ne menyre te Parregullt neni 291, Ndertim I paligjshem neni 199/a, Dhune ne familje neni 130/a, Mbajtjes pa leje te armeve luftarake neni 278, Vjedhje te energjise elektrike neni 137, Kalim I Paligjshem I Kufirit neni 297 etj.

Çeshtjet penale te pezulluara gjate vitit 2016.

Rezulton se gjate vitin 2016 jane pezulluar per moszbulim te autoreve 785 ceshtje penale, te cilat ne krahasim me numrin e ceshtjeve te pezulluara ne vitin 2015 jane me shume.

pjesa me e madhe e te cilave kane qene te rregjistruara per vepren penale te “Kultivimit te Bimeve Narkotike”, parashikuar nga neni 284 i Kodit Penal.

Ka pesuar renie pezullimi tek ceshtjet penale te “Vjedhjes”, parashikuar nga Neni 134 nga 296 ceshtje te vitit 2015, ne 211 per vitin 2016. Kjo tregon eshte rritur zbulueshmeria e autoreve te vepres penale eshte rritur.

Ne 7 raste nuk eshte miratuar nga Drejtuesi i Prokurorise vendimi i pezullimit dhe eshte urdheruar rifillimi i procedimit penal

Çeshtjet penale te pushuara gjate vitit 2016.

Rezulton se gjate vitin 2016 eshte vendosur pushimi per 740 çeshtje penale, te cilat ne krahasim me numrin e ceshtjeve te pushuara ne vitin 2015 jane me shume. Nga keto 354 raste te pushimit te ceshtjeve penale, nje pjese e konsiderueshme e procedime, jane pushuar pasi eshte parashkruar vepra penale, ku pjesen me te madhe e ze vepra penale e vjedhjes se pasurise, kemi nje pjese te kunsiderueshme pushime te çeshtjes penale ne hetim, procedime penale, si dhe pushime te disa procedimeve penale si per nenin 248, 134, 199/a, 290/2, 186 etj.

Nga totali I çeshtjeve te pushuara, ne gjykatë janë ankimuar 42 çeshtje. Gjykata ne perfundim te shqyrtimit ne 18 raste ka vendosur lenien ne fuqi te vendimeve te pushimit, prej tyre 11 raste jane ankimuar dhe ndodhen per shqyrtim ne Gjykatën e Apelit. Ne 9 raste Gjykata ka vendosur prishjen e vendimeve te pushimit, prej tyre 6 raste jane ankimuar nga Prokurori dhe ndodhen per shqyrtim ne Gjykatën e Apelit. Ne 2 raste eshte pushuar Gjykimi dhe per 13 raste te tjera jane ne shqyrtim prane Gjykates se Shkalles se Pare Shkoder.

Kete vit rezulton se jane rifilluar 83 procedime penale nga keto jane rifilluar procedime penale te pushuara dhe procedime te pezulluara. Kryesisht keto ceshtje jane rifilluar pasi pjesa me e madhe e tyre ishte pezulluar per leterporosi te shteteve te huaja dhe rifillimi eshte bere me ardhjen e pergjigjeve nga autoritetet e huaja.

Ne shume raste, veprimet e para hetimore, si kqyrja e vendit te ngjarjes, zbulimi, fiksimi dhe marrja e gjurmeve dhe provave materiale qe kane lidhje me zbulimin e mekanizmit dhe autoreve, kane qene jo te plota dhe te kryera me mangesi te theksuara profesionale.

Kryerja e ketyre veprimeve me perpikmeri dhe pergjegjesi do te conte ne hetimin e plote te ngjarjes dhe zbulimin dhe venien para pergjegjesise penale te autoreve te kryerjes se tyre. Problem ky qe eshte shtruar dhe ne analizen e kaluar.

Ne 56 raste nuk eshte miratuar nga Drejtuesi i Prokurorise vendimi i pezullimit dhe eshte urdheruar rifillimi i procedimit penal

Çeshtjet penale te transferuara gjate vitit 2016

Rezulton se gjate ketij viti jane transferuar ne drejtim te prokurorive te tjera 39 ceshtje penale.

Kryesisht vendimet ne lidhje me shpalljen e moskompetences dhe kalimit te akteve jane arsyetuar drejte, jane marre ne nje kohe te shpejte menjehere pas konstatimit te faktit te moskompetences duke i kaluar aktet prokurorive perkatese.

Treguesit e te pandehurve ne ceshtjet penale te trajtuara gjate vitit 2016.

Gjate vitit 2016, nga ana e Prokurorise se Rrethit Gjyqesor Shkoder jane marre ne cilesine e te pandehurit 1208 shtetas me 412 persona nen hetim, nga te cilet 1099 te pandehur jane derguar per gjykim prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Shkoder ku 224 prej tyre ne gjendje arresti ne burg, per 150 persona nen hetim dhe 2 pandehur është pushuar çeshtja apo akuza, Per te pandehurit e tjere ose personat nen hetim vazhdojne hetimet paraprake.

Treguesit e masave te sigurimit ne ceshtjet penale te trajtuara gjate vitit 2016.

Gjate vitit 2016, ne Prokurorine e Rrethit Gjyqesor Shkoder jane referuar nga policia gjyqesore 593 arrestime ne flagrante, 40 ndalime si dhe 7 ndalime me urdher te prokurorit. Lidhur me kete persona te arrestuar dhe ndaluar nga ana e prokurorise jane perpiluar ne total dhe kerkuar ne gjykate 371 arrest ne burg, 8 arrest ne mungese, 12 arrest ne shtepi, 8 arrest me afat, 2 garanci pasurore dhe 189 detyrim per paraqitje. Nga ana e Gjykates se Rrethit Gjyqesor Shkoder ne lidhje me kerkesat tona jane vendosur keto masa sigurimi: 219 arrest ne burg, 10 arrest ne burg ne mungese, 110 arrest ne shtepi, 21 arrest ne burg me afat 8 garanci pasurore, 250 detyrim per paraqitje

Ne lidhje me keto kerkesa nga ana e Gjykates se Rrethit Gjyqesor Shkoder eshte vendosur ne shumicen e tyre pranimi si te bazuara ne ligjin procedural penal dhe provat e administruara. Ne cdo rast kur nuk eshte perkrahur kerkesa jote eshte ushtruar apel sipas ligjit procedural penal.

Me konkretisht treguesit e masave te sigurimit personal dhe pasuror jane si me poshte;

Totali i arresteve/ndalimeve	Lirim i menjehershëm Neni 257	Kerkesa e prokurori se Neni 258	Vendimi i gjykates Neni 259
Vleftesime te ligjshme			673
Vleftesime te paligjshme			18
Lirime menjehershme		4	
Arrest ne burg		371	219
Arrest me afat		8	21
Arrest ne shtepi		12	110
Detyrim paraqitje		189	250
Arrest burg ne mungese		8	13
Masa ndaluese			
Neni 239 K.Pr. Penale		1	1
Garanci pasurore		2	8

Treguesit e menyres se perfundimit te gjykimit te ceshtjeve penale te trajtuara gjate vitit 2016.

Gjate vitit 2016, nga ana e Prokurorise se Rrethit Gjyqesor Shkoder jane perfunduar gjykimet e 902 ceshtjeve penale, prej te cilave: 87 ceshtje me gjykim te drejteperdrejte me 87 te pandehur, 117 ceshtje me gjykim te zakonshem me 123 te pandehur, 622 ceshtje me gjykim te shkurtuar me 677 te pandehur dhe 1 gjykime ne mungese me 1 te pandehur.

Me konkretisht treguesit e gjykimit te ceshtjeve penale jane si me poshte;

Totali i ceshtjeve te gjykuara	Gjykim i drejteperdrejte	Gjykim i shkurtuar	Gjykim i zakonshem
902	87	622	117

Nga totali i ceshtje te gjykuara, nga ana e organit te prokurorise eshte kerkuar denimi i te pandehurve si me poshte: 112 raste eshte kerkuar minimumin i denimit, 487 raste mesatare e denimit, 7 raste maksimumi, denim me kusht sipas nenit 59 jane kerkuar 197 raste si dhe jane kerkuar 195 raste denim me gjobe. Gjate viti 2016, ne masen e denimit me burg nga ana e Prokurorise eshte kerkuar, ne disa raste, zevendesimi i denimit me burg me nenin 63, 53/a, 59/a te K.Pr.Penale gje e cila eshte vendosur dhe nga Gjykata.

Nga ana e gjykates jane vendosur keto masa denimi si me poshte: gjobe 110 raste, denim minimum ne 167 raste, denim mesatar ne 237 raste, denim maksimal ne 2 raste, burgim te perjetshem ne rast(nje rast gjykim I shkurtuar dhe I pandehuri marre denimin maksimal), denim me kusht sipas nenit 59 te K.Penal ne 424 raste, neni 53 ne 9 raste.

Ne vijim te kesaj pike po japin nje permbledhje te kerkesave per denimin te organit te prokurorise dhe vendimet e marra prej gjykates lidhur me keto kerkesa:

Llojet e denimeve	Kerkesa e prokurorise per raste	Vendimi i gjykates
Denim me gjobe	195	110
Denim me burgim (mesatar)	487	237
Denim me burgim (maksimal)	7	2
Denim me burgim (minimum)	112	167
Pezullim ekzekutimi denimi	197	424
Burgim te perjetshem	1	1
Terheqje aktesh		
Pushim ceshtje	14	24
Pafajsi		63

Eshte e rendesishme te theksohet se te gjitha ceshtjet jane ankimuar nga ana e prokuroreve perkates dhe aktualisht jane ne proces gjykimi ne Gjykatën e Apelit Shkoder.

Shpejtesia ne hetime, dhe zgjatja e afatit te hetimeve paraprake gjate vitit 2016.

Gjate vitit 2016 rezulton se nje pjese e ketyre e ceshtjeve penale te regjistruara te reja jane perfunduar brenda afatit ligjor dhe kryesisht per ceshtje penale me persona te arrestuar ne hetim.

Lidhur me nje ndarje te grup veprave ne te cilat eshte marre vendim per zgjatjen e afatit te hetimeve paraprake, rezulton se per veprat penale kunder personit jane marre 37-vendime zgjatje afati. 80 vendime jane marre per vepra penale kunder pasurise, 76 vendime jane marre per veprat penale kundër autoritetit të shtetit dhe 1 veper penale kundër drejtësisë. Pjesa me e madhe e zgjatjeve eshte marre ne hetimin e ceshtjeve te Njesise se perbashket te hetimit, nisur kjo nga natyra e veprave penale qe heton kjo njesi si dhe e veprimeve te shumta hetimore qe del e domosdoshme per hetimin.

Apelimet e bera nga Prokuroria Prane Gjykates se Shkalles se Pare Shkoder gjate vitit 2016.

Gjate vitit 2016, nga Prokuroria Prane Gjykates se Shkalles se Pare Shkoder jane paraqitur ne gjykate ne total 499 apelime per vendime perfundimtare te gjykates. Keto apelime jane ushtruar kunder vendimeve gjyqesore per te cilat nga ana e Gjykates se Rrethit Gjyqesor Shkoder jane dhene vendime pafajesije dhe pjesa tjeter jane bere kunder vendimeve gjyqesore per te cilat nga gjykata ka patur ndryshime te raportit per masen e demimit nga kerkesa e Prokurorit dhe Vendimit te Gjykates. Po keshtu, jane paraqitur edhe 227-apele per masa sigurimi personal nga ana e prokurorit.

Ngarkesa e punes se Prokuroreve dhe oficereve te policise gjyqesore gjate vitit 2016.

Gjate vitit 2016, nga ana e prokuroreve te Prokurorise se Rrethit Gjyqesor Shkoder eshte perballuar nje ngarkese e konsiderueshme ceshtjes penale dhe zhvillime gjykimesh prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Shkoder. Ashtu sic edhe e kemi trajtuar ne piken e pare te ketij raporti, rezulton se nga prokuroret eshte hetuar dhe perfunduar nje numer i madh ceshtjes penale.

Me konkretisht po japin ne nje table permbedhese te dhenat e ngarkeses se secilit prokuror dhe menyren e perfundimit te ceshtjeve prej tyre.

	Data							Ne Hetim
Prokurori ceshtjes	Nr.Proç	Proc.Përfund uar	Dërg. Gjyqit	Pushua r	Pezullu ar	Dërg. për komp	Proc. Bashkim	2017
A.Bushati	4	4	4					0
A.Halilaj	117	64	51	8	4		1	53
A.Marku	122	99	43	18	23	8	6	23
A.Martini	140	78	41	4	18		15	62
A.Murçaj	44	33	21	9	2		1	11
A.Smaçi	178	109	41	15	48	5		69
B.Hamza	42	15	9	4	1		1	27
E.Cufi	192	116	40	6	65		5	76
E.Lelçi	137	88	38	8	35	2	5	49
E.Ndoci	138	50	29	9	9		2	88
F.Laloshi	155	111	76	13	21		1	44
F.Lekani	41	19	14	4	1			22
K.Beluri	1							1
L.Çardaku	194	174	108	18	44	1	3	20
M.Frasherri	125	93	38	12	36		7	32
M.Shtjefni	43	38	19	2	16		1	5
S.Bahiti	30	12	3	5	1	1	2	18
S.Pashuku	26	22	17	4			1	4
Sh.Milla	151	104	41	18	28	8	9	47
V.Staka	202	162	98	26	30	4	4	40
Xh.Lita	114	68	46	17	3		1	46
Totali	2196	1459	777	200	385	29	65	737

Nje pjese te konsiderueshme te ngarkeses se punes se secilit prokuror ze edhe pjesmarrja ne gjykim, te cilen e kemi analizuar me treguesit e mesiperm.

Gjate vitit 2016 edhe oficeret e policise gjyqesore prane Prokurorise se Rrethit Gjyqesor Shkoder kane patur nje ngarkese te konsiderueshme dhe konkretisht;

Nr.	Oficeri Pol. Gjyqesore	Totali i ceshtjeve
1	A.Fejzullari	96
2	B.Vujoshi	41
3	E.Caku	181
4	K.Como	92
5	K.Livalli	98
6	L.Tusha	170
7	S.Doda	79
8	S.Kerxhaliu	189
9	E. Gjoni	155
10	F.Vata	186

Ne totalin e ketyreve veprave penale,me hetimin e tyre jane marre dhe oficeret e policise gjyqesore prane Drejtorise se Policise Shkoder,te Komisarariatit te Policise M.Madhe ,oficerte e seksionit te prokurorise prane Drejtorise se Policise Shkoder si dhe oficeret e njesise se perbashket te hetimit ,ku ngarkesa e tyre do te paraqitet ne menyre analitike me poshte.

Ekzekutimet e vendimeve penale .

Ne Prokurorine e Rrethit Gjyqesor Shkoder, per ekzekutimet e vendimeve penale gjate vitit 2016 ka qene i ngarkuar prokurori Agron Bushati.

Gjate vititi 2016 jane vene ne ekzekutim te gjithe vendimte penale te formes se prere duke respektuar afatet ligjore te parashikuar ne nenin 49 te Ligjit nr.8331 date 21.04.1998 (Per ekzekutimin e vendimeve penale); 1808 Urdhera per Ekzekutimin E Vendimeve Penale vendime penale e konkretisht 138 vendime me burg, 145 vendime me gjobe, 13 denime plotesuese, 354 vendime sipas nenit 59 te K.Penal, 18 vendime sipas nenit 59/a dhe dhe 43 vendime sipas nenit 63 te K.Penal.Nga keto urdhera te nxjerre jane ekzekutuar :128 vendime me burg, 202 vendime me gjobe, 18 denime plotesuese, 41 vendime sipas nenit 59/a, 27 vendime sipas nenit 63 dhe 609 vendime sipas nenit 59 te K.Penal.

Nga ana e sektorit te ekzekutimit te vendimeve penale eshte bere nje pune shume e mire lidhur me nxjerrjen e urdherave te kerkimit nderkombetar ne zbatim te kerkesave te reja ligjore qe kane sjelle ndryshimet e legjislacionit ne kete fushe. Keshtu ne zbatim te udhezimit te Prokurorit te Pergjithshem ne bashkepunim me Ministrine e Rendit nga kjo prokurori jane nxjerre disa udhera per kerkim nderkombetar.

Marredheniet juridiksionale me jashte gjate vitit 2016.

Gjate vitit 2016, rezulton se ka patur nje ngarkese te konsiderueshme pune edhe ne lidhje me marredheniet juridiksionale per autoritetet gjyqesore te huaja dhe konkretisht gjate ketij viti jane derguar per jashte shtetit 54 kerkesa per ndihme juridike ne fushen penale dhe jane ekzekutuar 12 leterporosi nga jashte. Nga jashte kane ardhur per tu vene ne ekzekutim 30 leterporosi prej te cilave vetem 1 nuk eshte ekzekutuar. Jane derguar 4 kerkesa per ekstradim nga Prokuroria per ne Gjykate, prej te cilave per 3 kerkesa eshte vendosur pranimi I ekstradimit, per njeren eshte ushtruar ankim nga I denuari ne Gjyktaten e Apelit dhe per njeren Gjykata ka vendosur kthimin e akteve ne Ministrine e Drejtesise. Ka patur 10 kerkesa ne Prokurori per njohjen e vendimeve penale te huaja, ne 1 rast Gjykata ka vendosur shpalljen e mos kompetences dhe ne te gjitha rastet e tjera eshte vendosur njohja e vendimeve. Nga te cilat 8 ndodhen per shqyrtim ne Gjykatën e Apelit.

Gjithashtu ka nje numer te konsiderushem rastesh kur eshte bere njoftimi per llogari te autoriteteve te huaja per persona te denuar apo qe kane procedim penal ne shtetin qe kerkon njoftimin (si ne cilesine e te pandehurit ashtu dhe ne cilesine e deshmitarit).

Ushtrimi i rolit dhe kompetencave te Drejtuesve te Prokurorise.

Ne veprimtarine e ushtrimit te ndjekjes penale per çeshtjet e hetuara dhe te perfaqesuara ne gjykim, nje rol luan dhe ushtrimi i kontrollit nga Drejtuesit e Prokurorise, ne lidhje me studimin dhe vendimarrjen per regjistrimin e çeshtjeve penale, kontrollin ne dinamike, menyres se perfundimit te çeshtjeve, si dhe krijimit te marredhenieve me Prokuroret dhe Of/Pol/Gjyqesore, te seksionit te Prokurorise dhe seksioneve dhe sherbimeve te Policise, si dhe me Institucionet e tjera . Roli aktiv i Drejtuesve te kesaj Prokurorie pervec sa thame me lart eshte i shprehur qartë në vendimet e shfuqizimeve te vendimeve te dergimit ne Gjyq per shkak te ndryshimeve ne akuzat e ngritura dhe çeshtjet jane riderguar ne Gjyq, te 6 vendimeve te pushimit, te 16 vendimeve te mosfillimit gjate vitit 2016.

Gjate periudhes qe analizojme nga drejtuesit e Prokurorise eshte ushtruar studimi i te gjitha materialeve kallzuese dhe te referuara nga Policia Gjyqesore e ato me vendngjarje, duke marre vendimet perkatese per regjistrimin e çeshtjeve.

Ne te gjitha rastet eshte bere perpjekje per nje respektim te nje proporcionaliteti ne shperndarjen e ngarkeses per Prokuror dhe Of/Pol/Gjyqesore kjo e evidentuar dhe ne statistiken e lartepermendur

Urdherat dhe udhezimet e Zyres se Prokurorit te Pergjithshem, jane punuar dhe diskutuar per implementimin e tyre. Kujdes eshte bere per respektimin dhe zbatimin e urdherit te perbashket te Prokurorit te Pergjithshem dhe Ministrit te Brendeshem, per funksionimin e Sherbimeve te Pol/Gjyqesore ne Policine e Shtetit date 15.04.2008.

Eshte ushtruar kontroll ne dinamike te çeshtjeve penale gjate hetimeve paraprake, jane evidentuar dhe kerkuar verbalisht veprime konkrete qe duhet te kryhen, dhe nga ana drejtuesit te prokurorise eshte vendosur dhe shfuqizimi i disa vendimeve qe u cituan me lart.

Ne te gjitha rastet e zgjatjeve te afatit te hetimeve kerkesave per vleftesim dhe caktim mase sigurimi, si dhe konkluzioneve perfundimtare eshte zbatuar me korrektesi Urdheri i Prokurorit te Pergjithshem ne lidhje me kontrollin dhe ciklimin e ketyre akteve dhe administrimin te nje kopje ne fashikullin perkates.

Jane organizuar dhe kryer analiza per çeshtje te veçanta te herepashershme, te protokolluara, ku eshte urdheruar me shkrim kryerja e veprimeve hetimore plotesuese, si dhe ne shume raste jane dhene urdhera per riformulimin e akteve apo vendimeve perfundimtare.

Marredheniet me institucionet.

Eshte krijuar nje marredhenie institucionale korrekte dhe bashkepunuese me Institucionet e tjera, me Komisaritet e Policise , Drejtorine e Policise se Qarkut, si dhe Gjykatën e Rrethit Gjyqesore dhe Prokurorine e Apelit Shkoder, etj.

Nga marredheniet qe burojne per shkak te veprimtarise dhe procedurave ligjore, te hetimit dhe perfaqesimit ne gjygj, pra me Policine dhe Gjykatën, jane krijuar marredhenie bashkepunimi si ne aspektin organizativ ashtu dhe ate ligjor ne respektim te kryerjes se detyrave ne afate nga seksionet e Policise Gjyqesore dhe sherbimet, ashtu dhe respektimin dhe korrektesine ne zhvillimin e seancave gjyqesore me Gjykatën. Jane evidentuar raste te shtyrjes se seancave gjyqesore per mosparaqitjen e Prokuroreve, por gjithmone shtyerjet kane qene per faktin e nje ngarkese te madhe nga ana e Prokurorise.

Ne lidhje me materiale kallezuese jo te plota, kur jane evidentuar mangesi etj, nga ana e Drejtuesit te Prokurorise jane derguar me shkrim verejtjet per problematiken e konstatuar ne materiale kallzuese dhe çeshtje penale te veçanta, ku eshte konfirmuar nga ana e Drejtuesve te Policise trajtimi i problematikave te ngritura ne funksion te permiresimit te punes.

Gjithashtu duhen evidentuar marrëdhëniet me Zyren e Prokurorit të Përgjithshëm, në funksion të zbatimit të urdherave dhe udhëzimeve të ardhura. Vlersojme se nga nxjerrja e tyre kanë gjetur zbatim dhe përmirësuar puna e veprimtarisë së Prokurorisë në hetimin e çështjeve dhe përfaqësimin në gjykim. Gjithashtu ka patur një bashkëpunim për të evidentuar me Zyren e Marrëdhënieve me Jashtë, në lidhje me ekzekutimin e letrë-porositive me autoritetet e huaja, dhe praktikave për njohje vendimeve penale të huaja të cilat kanë rezultuar në një numër të konsiderueshëm këte vit, siç u përmenden më lart.

Është për të theksuar dhe lavdëruar puna të mira të prokurorëve të lidhur me pjesëmarrjen në vendngjarje. Kështu në veprat penale të vrasjeve ose tentativës së vrasjes, shkeljes së rregullave të qarkullimit të rrugës, me pasoja të rënda, vjedhjeve të dhunës, shkatërrimit të pronës me eksploziv dhe çdo rast tjetër që është çmuar i nevojshëm, prokurorët kanë qenë të pranishëm në vendngjarje duke marrë pjesë për drejtimin, orjetimin e veprimeve hetimore dhe duke kryer dhe vetë veprimet hetimore të rëndësishme.

MARREDHENIET ME MEDIAN DHE PUBLIKUN

MARREDHENIET ME PUBLIKUN

Ne lidhje me publikun eshte per tu theksuar fakti se nga ana e prokuroreve por edhe e drejtuesit, eshte mundesuar vazhdimisht pritja me korrektesi e ankesave, shqetesimeve te qytetareve duke u munduar t'u jepet nje zgjidhje sa me e shpejte, e drejte dhe ligjore. Natyrisht qe parashtrimi i problemeve nga ana e publikut nuk eshte kufizuar vetem ne nje dite te vecante pasi stafi yne gjate gjithc kohes eshte ne ushtrim te detyres se tij.

MARREDHENIET ME MEDIAN

Brenda kuadrit te majtjes se sekretit hetimor por ne respektim edhe te te drejtave te qytetareve per informim, jemi munduar te ruajme nje marredhenie sa me korrekte me median, ku cdo informacion, lidhur me publikimin e vendimeve te Gjykates kemi komunikuar me zedhenesin per shtyp ne Prokurorine e Pergjithshme. Jemi munduar pa cenuar prezumimin e pafajesise, te drejten private si dhe ne mbrojtje te te drejtave te te miturve.

Administrimi i Prokurorise

Ne mbarevajtjen e punes te veprimtarise se Prokurorise nje rol te rendesishem kryen dhe administrata e Prokurorise. Rezulton se gjate vitit 2016 eshte punuar ne permiresimin e punes se mbajtjes se regjistrave dhe raportimeve periodike te statistikave te Prokurorise. Gjithashtu eshte punuar per venien ne zbatim te sistemit CAMS. Persa i perket respektimit te disiplines ne pune dhe te Etikes nga ana e punonjesve te kesa Prokurorie ne rastet e mos zbatimit jane marre masa konkrete nga ana e Drejtuesit.

Lidhur me anen **financiare** institucioni jone eshte perpjekur per te qene korrekt ne zbatimin e ligjit dhe mire administrimin e fondeve buxhetore

Prioritetet e punes per vitin 2016.

Referuar treguesve te siperpermendur, duhet te evidentojme dhe drejtimet kryesore te punes dhe veprimtarise per vitin ne vazhdim 2016, duke percaktuar dhe prioritetet kryesore.

Nje nder drejtimet kryesore te veprimtarise se punes per vitin 2016, duhet evidentuar se pari ngritja e cilesise se punes, pra e cilesise dhe shpejtesise se veprimeve gjate hetimeve te procedimeve penale. Cilesia ne veprime pasqyron se pari ngritjen profesionale te çdo Prokurori dhe Oficeri te policise gjyqsore, duke e pasqyruar ate ne perpilimin e akteve, formulimit dhe arsyetimit ligjor te vendimeve gjate hetimit, ato perfundimtare si dhe perfaqesimit ne Gjykate.

Duhet rritur ndjeshem kontrolli ne dinamike nga ana e prokuroreve gjate hetimeve paraprake te çeshtjeve, duke mos u mjaftuar vetem me nxjerrjen e nje urdheri per kryerje veprimesh hetimore, pritjen deri ne ardhjen e akteve nga sherbimet e Policise Gjyqesore, duke shkaktuar vonesa ne hetim, humbjen e aktualitetit te nje veprimi hetimore qe mund te rezultoje gjate dinamikës etj.

Per çeshtje te veçanta per shkak te rrezikshmerise shoqerore apo perhapjes se nje krimi duke ju referuar tendences pra te kriminalitetit, duhet bere vleresimi i diferencuar, kryer analiza te vleresimit te hetimeve dhe provave te administruara, duke lene detyra konkrete, si dhe duke kryer vete nga Prokuroret veprime hetimore.

Gjithashtu duke ju referuar nje numri çeshtjesh penale tashme te regjistruara per veprat penale te parashikuara nga nenet 248 dhe 186 K.Penal, si dhe ato qe lidhen me veprime korruptive duhet te jene ne prioritetet e punes tone hetimi i ketyre çeshtjeve penale, te cilat kane te bejne me subjekte te administrates shteterore.

Mendoj se gjate ketij viti ne prioritetet e punes duhet te jete dhe nxitja dhe diskutimi me seksionin e Luftes Kunder krimit ekonomik evidentimi i veprave penale te parashikuara nga nenet 248 dhe 186 e vijim te K.Penal si dhe te atyre qe lidhen me veprime korruptive te subjekteve te administrates shteterore.

Duhet pare me prioritet dhe urdheri i Prokurorit te Pergjithshem ne lidhje me implementimin e ligjit “Antimafia”, si nje detyrim ligjor dhe efikas. Çeshtjet e referuara ne lidhje me vepren penale te “pastimit te parave” duhen vleresuar si prioritete te punes sone per vitin 2016.

Duhet kuptuar me drejte dhe zbatuar kompetencat e Prokuroreve ndaj strukturave te Policive Gjyqesore.

Gjithashtu nga evidentimi i nje mangesie te vitit 2015 ne lidhje me kryerjen e veprimeve hetimore nga vete Prokuroret, kete vit duhet vleresuar me korrektesi sidomos zbatimi i neni 256 te K.Pr.Penale ne lidhje me pyetjen e te arrestuarve, perfundimi i hetimeve qe shpesh eshte deleguar Of/Pol/Gjyqesore.

Zbatimi me perpikmeri i nenit 246 te K.Pr.Penale per njoftimin e gjykates brenda 2 muajve ne cshtjet penale me te arrestuar etj.. Po ashtu duhet te forcohet me shume puna ne kontrollin dhe mundesine e rifillimit te hetimeve per ngjarje te vjetra qe kete rreth kane qene te shumta dhe mjaft te renda

DREJTUESI I PROKURORISE

Granit SHAHU